



## AGJENCIA PËR PËRKRAHJE FINANCIARE NË BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL

Në bazë të nenit 7, alinea 9 të Ligjit për themelim të Agjencisë për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural ("Gazeta Zyrtare" e Republikës së Maqedonisë nr. 72/2007, 5/2009, 43/2014, 193/2015 dhe 39/2016), Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural shpall në vijim:

### THIRRJE PUBLIKE nr. 01/2017

#### për dorëzimin e kërkesave për shfrytëzim të mjeteve nga Programi për përkrahje financiare të zhvillimit rural për vitin 2017

#### I. LËNDA E SHPALLJES

Lëndë e kësaj shpalljeje është ndarja e përkrahjes financiare për masat në vijim:

Grupi i masave	Emri i masës
Masa 131	<p>Bashkimi ekonomik i ekonomive bujqësore për kryerje të përbashkët të veprimtarisë bujqësore dhe mbështetje financiare për themelim dhe funksionim të kooperativave bujqësore</p> <p>Mjetet parashihen për:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Themelimin dhe funksionimin e kooperativave bujqësore të regjistruara në Regjistrin e kooperativave bujqësore pranë MBPEU</li> <li>Ndihmë e premive për sigurim si lloj kompensimi të pjesës së shpenzimeve për sigurim edhe atë në shumë që nuk do të kalojë 70% të shpenzimit për sigurim të kapaciteteve prodhuese të kooperativës bujqësore me kapacitet të vogël dhe 80% për sigurim të kapaciteteve prodhuese të kooperativës bujqësore me kapacitet të madh, por jo më shumë se 3.000.000 denarë në nivel vjetor</li> </ul>
Shpenzimet e pranueshme për bashkim ekonomik të ekonomive bujqësore për kryerje të përbashkët të veprimtarisë bujqësore	<ul style="list-style-type: none"> <li>Përkrahja financiare për themelim të kooperativave bujqësore dedikohet për mbulimin e një pjese të shpenzimeve për themelim të kooperativës bujqësore, vendosje të kapaciteteve administrative dhe teknike, ndihmë për angazhim të subjekteve profesionale</li> <li>Pagesë për personin drejtues i kooperativës bujqësore që në pajtim me kushtet e caktuara mund të realizojë të drejtë për ndihmë të këtij lloji me shumë prej 100% në vitin e parë, nga pagesa mesatare e paguar në Republikën e Maqedonisë për vitin paraprak, me ulje prej 20% për çdo vit të ardhshëm në periudhë jo më të gjatë se pesë vjet.</li> <li>Për angazhimin e një personi nga sferat e shkencave bujqësore dhe veterinës, në pajtim me llojin e kooperativës bujqësore në shumë jo më shumë se pagesa mesatare e paguar në Republikën e Maqedonisë për vitin paraprak (për kooperativat bujqësore me kapacitet të madh)</li> </ul>

#### II. TË DREJTË PËR SHFRYTËZIMIN E MJETEVE

Të drejtë për shfrytëzimin e mjeteve kanë subjektet në vijim:

##### Subjektet

Kooperativë bujqësore e regjistruar në pajtim me Ligjin për kooperativa bujqësore

#### III. SHUMA E PËRKRAHJES FINANCIARE

Përkrahja financiare ndahet në shumë prej 100% nga shpenzimet e përgjithshme të pranueshme.

#### IV. KUSHTET PËR SHFRYTËZIMIN E MJETEVE DHE DOKUMENTACIONI I CILI DUHET TË DORËZOHET

Kërkesat për masat veç e veç dorëzohen në origjinal.

Kushtet të cilat duhet të plotësojnë kërkesit e mjeteve janë përcaktuar me:

- Programi për përkrahje financiare të zhvillimit rural për vitin 2017 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 192/2016 dhe 7/2017)
- Ligjin për kooperativat bujqësore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 23/13, 51/15, 193/15 dhe 39/16)

Nëse deri tek Agjencia parashtrohen më shumë kërkesa sesa që ka mjete të disponueshme për masën 131, në pajtim me Programin për përkrahje financiare të zhvillimit rural për vitin 2017. Agjencia do të japë përparësi atyre kërkesave që kanë parashtruar kërkesën e tyre më herët se të tjerët.

#### V. MARRJA E FORMULAREVE DHE UDHËZIMEVE

Formularët "Kërkesë për pagesë" me listën e dokumenteve të nevojshme mund të merren në ueb faqen e Agjencisë [www.ipardpa.gov.mk](http://www.ipardpa.gov.mk).

Formularët e lartpërmendur mund të merren edhe drejtpërdrejtë në Agjenci çdo ditë pune prej ora 8:30 deri në ora 16:30 në adresën:

**Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural,  
Bul. "3-ta Makedonska Brigada" nr. 20  
(ndërtesa e Makedonija Tabak blloku C)  
1000 Shkup**

#### VI. MËNYRA E DORËZIMIT TË DOKUMENTEVE

Kërkesat e plotësuara për pagesë të mjeteve nga Programi për përkrahje financiare të zhvillimit rural për vitin 2017 së bashku me dokumentacionin e tërësishëm të nevojshëm dorëzohen në gjuhën maqedonase në zarf të mbyllur në të cilin në pjesën e parme në këndin e epërm të majtë qëndron shenja "MOS HAP", për shpalljen publike nr. 01/2017 dhe shënim të shifrës së masës për të cilën dorëzohet kërkesa. Kërkesa mund të dorëzohet me postë ose personalisht në sportelin e Agjencisë, në të kundërtën Agjencia nuk ndërmerr përgjegjësi për arritje të vonuar ose të pakompletuar në sportel ose për hapje të parakohshme të kërkesës.

**Përkrahja për këtë masë paguhet në mënyrë kuartale pas kërkesës së parashtruar për pagesë edhe atë:**

-për kuartalin e parë më së voni deri më 15 prill 2017

-për kuartalin e dytë më së voni deri më 15 korrik 2017

-për kuartalin e tretë më së voni deri më 15 tetor 2017 dhe

-për kuartalin e katërt më së voni deri më 31 dhjetor 2017.

**Kërkesat e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk do të merren parasysht gjatë shqyrtimit.**

Kontakt:

Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural, Sektori për lejm të pagesave.

Telefoni 02 3097 - 460, çdo ditë pune prej 10.00 deri në ora 14.00

E-mail: [ipardpa.info@ipardpa.gov.mk](mailto:ipardpa.info@ipardpa.gov.mk), [www.ipardpa.gov.mk](http://www.ipardpa.gov.mk).



AGJENCIA PËR PËRKRAHJE FINANCIARE NË BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL